

Ridvan (Ahmet) Qatani

(19.03.1965, shqiptar nga fshati Duhël/Dulje, komuna e Suharekës/Suva Reka, tre fëmijë)

Në ditën kur forcat serbe e sulmuan fshatin, më 25.08.1998, vëllezërit Isufi dhe Ridvani me familje e kanë braktisur Duhlën/Dulje dhe u strehuan në pyllin e afërt të quajtur *Kopaq/Kopač*. Të nesërmen [26.08.1998], vëllezërit Qatani me komshiun Sahitin u kthyen në fshat për të marr ca rroba dhe ushqime për fëmijët. Pastaj, Isufi dhe Ridvani u nisën drejt strehimorese me automobilin e tipit *Lada*, ndërkaq komshiu Sahiti i përcillte me traktor. Në periferi të fshatit, te vendi i quajtur *Te Bërryli/Lakat [Duhël/Dulje]*, hasën në forcat serbe, të cilat pa asnjë paralajmërim shtënë ndaj tyre. Isufi dhe Ridvani u qëlluan për vdekje menjëherë. Sahiti, i cili gjendej pas tyre, kërcëu nga traktori dhe iku me vrap. Në mbrëmje, axha i Isufit dhe i Ridvanit, Sahiti, me disa komshinj shkuan dhe i morën trupat, të cilat i varrosën menjëherë në pyllin *Kopaq/Kopač*. Pas përfundimit të luftës, më 3.05.2000, mbetjet mortore të Isufit dhe Ridvanit u rivarrosën në varrezat e fshatit Duhël/Dulje.

Burimet: R. Shkodra, *Imamet...*, 69; deklarata B.Q, FDH-10952; deklarata S.S, FDH-6721; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; *Serb Troops Execute Four Albanians in Suhareka*, newsletter, KIC, 27.08.1998, FDH-29513.

Xhelal (Emin) Kuqi

(2.01.1965, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, hotelier, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naim (Hajrullah) Berisha

(10.11.1966, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, i papunë, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Xhelali ka qenë veprimtar i *Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës* në vitet para shpërthimit të luftës në Kosovë. Gjatë vitit 1998, policia e kishte arrestuar dy herë. Po ashtu, ishte dënuar dy herë. Herën e parë me dy, ndërkaq herën e dytë me katër muaj burgim. Pas lirimit nga burgu në muajin gusht, aderoi në radhët e UÇK-së. Në datën 26.08.1998, me Naimin kanë shkuar në vizitë te familja, e cila ishte strehuar në shtëpinë e Sabrije Kuqit

[*Suharekë/Suva Reka*]. Atje i kaluan disa orë, ndërkaq pas mesnate, më 27.08.1998, u nisën për një vizitë te familja e Naimit, shtëpia e të cilit ishte afro 100 metra larg. I ati i Xhelalit u tërhoqi vërejtjen se përreth shtëpisë së Naimit kishte policë serb. Xhelali dhe Naimi i morën armët e veta. Dhjetë minuta pas shkuarjes së tyre, u dëgjuan të shtëna nga armët e ndryshme. Në mëngjes, i ati i Xhelalit ka mësuar nga Mehmet Kuqi nga Këshilli për Liritë dhe Drejtat e Njeriut se Xhelali dhe Naimi kishin pësuar në oborrin e Naimit, duke iu kundërvu policëve serb. Familjet i kanë varrosur Xhelalin dhe Naimin në varrezat e Suharekës/Suva Reka më 28.08.1998.

Burimet: deklarata E.K, FDH-32548; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KMKMRF, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 483; Fotografi, FDH-20988; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e dëshmoreve...*, FDH-36427.

Izet (Shefket) Bytyqi

(1.09.1949, shqiptar nga Semetishti/Semetište, komuna e Suharekës/Suva Reka, tregtar, katër fëmijë)

Forcat serbe e kanë filluar bombardimin e *Semetishtit/Semetište* më 27.08.1998. Familja e Izetit me banorë të tjerë e kanë braktisur fshatin dhe kaluan në Nishor/Nišor, ndërkaq Izeti ndenji vetëm në shtëpi. Pas kësaj dite, nuk e kanë parë të gjallë kurrë më. Në fillim të muajit shtator, familjarët kanë dëgjuar nëpërmjet mediave se Izetin e kishin vrarë. Nga mesi i shtatorit, ata u kthyen në fshat. Mësuan nga kryetari i fshatit se pjesëtarë të forcave serbe e kishin vrarë Izetin në shtëpinë e tij. E kishin qëlluar me tre plumba në gjoks. Pas tërheqjes së forcave serbe, ushtarë të UÇK-së e kanë gjetur trupin e tij të pajetë. Banorët e fshatit e kanë varrosur Izetin në vendin e quajtur *Proni i Ftonjve/Potok dunja*. Pas përfundimit të luftës, në muajin dhjetor të vitit 2002, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata F.B, FDH-10984; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838.